

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse, në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

Duke konsideruar zhvillimin e mëtejshëm të reformës së administratës publike si një komponent kyç i grup-kapitujve “Themelorët” në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2024 në drejtim të:

Angazhimit për hapjen zyrtare të negociatave për grup-kapitujt “Themelorët”, i cili përfshin, mes të tjerash, edhe kriterin “Reforma në administratën publike”.

Përfshirjes zyrtarisht në Rrjetin Evropian të Administratës Publike (EUPAN) në kuadër të rritjes së ekspertizës në administratën publike.

Angazhimit për amendimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili do të adresojë sfidat kryesore të identifikuara për zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të ligjit të shërbimit civil.

Unifikimit të praktikave për menaxhimin dhe planifikimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil.

Rritjes së përqindjes së zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Administrimit gjatë vitit 2024 të 2 424 formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga subjektet vetëdeklaruese, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Zhvillimit të kapaciteteve të administratës publike përmes trajnimit pranë ASPA-s.

Zbatimit të Programit të Zhvillimit të Liderimit, që ka përfshirë 267 drejtues të mesëm dhe të lartë, nga të cilët 124 drejtues të rinj.

Kuvendi rekomandon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2025:

1. Të angazhohet në zhvillimin e një sistemi të avancuar të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së punonjësve të administratës publike mbi baza të matshme dhe transparente, që të përdoret edhe për identifikimin e nevojave për trajnime shtesë.

2. Të rrisë angazhimin në drejtim të rikthimit në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfites, me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore.

3. Të përgatisë një analizë për ecurinë e proceseve gjyqësore të kthimit në detyrë të nëpunësve civilë, problematikat e konstatuara, përgjegjësinë e strukturave përgjegjëse në dhënien e masave disiplinore dhe ndjekjen e tyre në proceset gjyqësore dhe përcaktimin e masave përkatëse në këtë fushë.

4. Të angazhohet në ofrimin e asistencës së nevojshme për njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin korrekt të procedurave të shërbimit civil.

5. Të thellohet bashkëpunimi i ASPA-s me institucionet homologe, autoritete të tjera dhe rrjete me ekspertizë në fushën e trajnimit të sektorit publik në BE dhe më gjerë.

6. Në bashkëpunim me ASPA-n, të angazhohet në hartimin e kurrikulave të reja trajnuese që fokusohen në përdorimin e platformave digjitale, inteligjencës artificiale dhe sigurisë kibernetike, me synim rritjen e aftësive digjitale të nëpunësve.

KRYETAR

Miratar në datën 6.11.2025